

JANI THOMAI

**REVISTA “STUDIME FILOLOGJIKE”  
SHKOLLË E FORMIMIT GJUHËSOR**

Përkujtimi i një jubileu si ky për 50-vjetorin e revistës “Studime filologjike” natyrisht do të ketë edhe frymë festive, por krahas kësaj do të shpërfaqë vlerat e ndihmesat që ka sjellë ky organ shkencor qendror në kaq vite, si laborator kryesor i përpunimit të mendimit shkencor shqiptar, nga fusha e gjuhësisë dhe e historisë së letërsisë, do të shpalosë arritjet më të mira të albanologjisë të pasqyruara, me rrezatim të drejtpërdrejtë e të gjerë në zhvillimin e shkencës së albanologjisë, si edhe në veprimtarinë mësimore të shkollës të të gjitha niveleve e në praktikën gjuhësore, të shkruar e të folur, në të gjitha fushat e përdorimit, sidomos të shqipes standarde.

Shumë nga studiuesit, ndër ata edhe unë, e kanë nisur rrugën e kërkimit shkencor me shkrimet e para të botuara në revista shkencore, si në revistën pararendëse, “Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës. Seria Shkencat Shoqërore”, e pas kësaj pikërisht në revistën “Studime filologjike”, ku ne, pak më të vjetrit, po hidhnim ca hapa më të sigurt. Kur tani u hedhim një sy atyre shkrimeve fillestare, disa na duken të thjeshta, madje ndonjë edhe me pohime naive, sa buzëqeshim vetë, por gjithsesi ato kanë qenë si hapat e parë të fëmijës që nis të përkëmbet e revista u bë si një zemërdhënëse bujare, që na përkrahte, por edhe na kërkonte të bënim më shumë e më mirë. Çdo autor ka përfituar nga diskutimet e shkrimeve në redaksinë e revistës, nga mendimet, idetë, vërejtjet e këshillat e “etërve” tanë shkencorë, të cilët na mësuhan hap pas hapi si të kuptojmë vetë shkencën e metodologjinë shkencore, si të njohim më gjerë trashëgiminë albanologjike e më thellë vetë gjuhën shqipe, si të zgjedhim objektin e studimit e si të hulumtojmë faktet, si t’i analizojmë e t’i argumentojmë të dhënat, si të nxjerrim përfundimet, madje edhe si t’i shprehim me “gjuhën” e shkencës. Për më tepër, në studimet e tyre ne shihnim modelin e lakmueshëm, tërheqës për ne të rinjtë, që nuk besonim ta arrinim, por dëshironim e shpresonim t’i afroheshim.

Kam pasur mundësinë për disa vjet të botoj në “Studime filologjike” shkrime shkencore, por edhe të jem anëtar i redaksisë së kësaj reviste. Ky organizëm, redaksia, si vetë revista, ka qenë vërtet një shkollë e lartë e kualifikimit shkencor, me dy burime të pasura informimi e formimi shkencor: Së pari, punimet që paraqiteshin për botim dhe që diskutoheshin më parë në redaksi me seriozitet e me përgjegjësi. Natyrisht përfitimin më të madh e kishin autorët e punimeve, por edhe ne, më të rinjtë e redaksisë, tek ato punime gjenim lëndë gjuhësore dhe të dhëna shkencore të panjohura, përfitonim nga

faktet e arsytimet që sillnin autorët e punimeve dhe nga gjithë trajtimi shkencor i tyre, nga shqyrtimi i çështjeve veçanërisht në punimet e profesorëve të njohur, si Eqrem Çabej, Mahir Domi, Shaban Demiraj, Selman Riza, Androkli Kostallari, Spiro Floqi, Lirak Dodbiba e të tjerë e deri nga punimet e kolegëve më të rinj në krijimtarinë shkencore, që na nxitnin të vinim në punë mendjen për t'i kuptuar e për të arsytuar shkencërisht. I dyti burim i pasur e shumë më cilësor ishin vetë diskutimet e profesorëve, me përgatitje të lartë e me logjikë shkencore të pakundërshtueshme, por edhe me dëshirën e sinqertë për të ndihmuar autorët e shkrimeve. Ne më të rinjtë kemi përfutur shumë nga secili prej tyre e nga të gjithë bashkë. Më janë ngulitur në mendje disa nga tiparet vetjake të modelit të diskutimeve të secilit: Profesor Eqrem Çabej të çonte te burimi shkencor rreth një të dhëne: “Për këtë shih edhe Petar Skokun...” ose “Miheku ka mendim tjetër të vetin për këtë çështje...” e në këtë mënyrë na mësonte edhe si të rendnim e të hulumtonim vetë për të hetuar çështjen ndër autorë të ndryshëm; profesor Mahir Domi, ndryshe, të shpjegonte pse ishte i gabuar mendimi yt dhe si duhej kuptuar e duhej interpretuar çështja, madje me durim vinte vetë dorë në punim, deri te pika e presja; profesor Shaban Demiraj na jepte të kuptonim mirë se edhe shkenca e gjuhësisë ishte shkencë e fakteve të vërteta, e argumentimeve, e interpretimeve dhe e përfundimeve të sigurta e të përpikta; profesor Androkli Kostallari i hapte horizont punimit duke e ushqyer me ide të tjera, për të cilat autorit mund të mos i kishte vajtur mendja: “Trajto këtu edhe veçoritë e fjalëformimit prefiksosufiks...”. Tani mbase i kemi harruar shumë imtësi të ndihmës së tyre konkrete, hollësitë e vërejtjeve, të mendimeve e të sugjerimeve, por ato janë aty në punimet tona të botuara në revistën “Studime filologjike”, të dhuruara me bujari dhe pa pretendimin për t'i cituar. Në redaksi profesorët tanë udhëhiqeshin nga fryma e synimi jo për ta hedhur poshtë pa diskutim si të pabotueshëm një punim relativisht të dobët, sidomos të ndonjë autori të ri a fillestar, por si të bëhej i botueshëm, duke plotësuar vërejtjet e sugjerimet e tyre, natyrisht kur autori pas kësaj e më tej, me punën e vet, mundte ta sillte punimin në një nivel shkencor të pranueshëm. Dhe, sipas rregullores së revistës, ata vetë, pa sqimë, ua nënshtonin punimet e tyre diskutimeve në këtë redaksi, duke mirëpritur me vëmendje dhe duke vlerësuar mendimet e të tjerëve. Në vitet e bashkëpunimit në redaksi, por edhe në diskutimet në sektorët e në Këshillin shkencor, janë sjellë ashtu që askush të mos ndiente asnjë farë peshe detyrimi ose kompleks inferioriteti si i ri a fillestar ende pa formimin e përvojën shkencore të një studiuesi. Ne më të rinjtë përkrah tyre padyshim më shumë kemi marrë se kemi dhënë. Kështu u rritëm vit pas viti duke synuar atë model dhe natyrshëm ky raport ndryshoi në drejtimin e duhur falë edhe ndihmës së tyre.

Të gjitha këto bënin që redaksia të ishte një organizëm shkencor i diskutimit të hapur, të ngritur e të lirë dhe revista “Studime filologjike” të ishte gjithnjë një përmbledhje studimesh me cilësi të lartë në pjesën më të madhe. Çdo numër kishte vlerat e më shumë se një monografie, me hapësirë të gjerë të kërkimit shkencor, nga shqipja e lashtë e shqipja e sotme, nga studimet dialektologjike e shqipja letrare, nga të gjitha nënsistemet e gjuhës, nga autorë shqiptarë e albanologë të huaj, nga studimet e mëhershme e ato bashkëkohore, nga gjuhëtarë të formuar e nga mësues, shkrimtarë e autorë të tjerë. Këtu nuk është e mundur, as e nevojshme, të sjellim bibliografinë aq të gjerë të studimeve të botuara në këtë revistë, qoftë edhe vetëm për ato të fushës së leksikologjisë, por në mënyrë të përgjithësuar mund të themi se, përveç lëndës së pasur leksikore e frazeologjike që sillen nga ligjërimet popullore, studimet, artikujt shkencorë e kumtesat lidhur me këtë fushë kërkimesh e mbulojnë thuajse gjithë hapësirën e saj: studime për fjalën, leksikun e shtresat leksikore të shqipes, për semantikën leksikore, për formimin e fjalëve e për huazimet leksikore, për frazeologjinë, për normën në leksik dhe pastrimin e pasurimin e tij, për leksikun dialektor e të autorëve, për stilistikën leksikore, për terminologjinë e fushat terminologjike, për leksikografinë njëgjuhëshe e shumëgjuhëshe dhe për fjalorë të veçantë (si *Fjalor i gjuhës shqipe*, 1954, *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe*, 1980 etj.). Vend të veçantë kanë zënë çështjet ndërdisiplinore, si zhvillimet leksiko-semantike në kushtet historike, etnokulturore e të marrëdhënieve të shqipes me gjuhë të tjera, studimet etimologjike në fushë të shqipes, veçori të leksikut të shqipes në periudha të ndryshme të zhvillimit të shoqërisë shqiptare, ndërlidhjet e semantikës leksikore e gramatikore, gërshetimi i leksiko-stilistikës me stilistikën letrare, trashëgimia leksikore dhe neologjia, dialektizmat, kultura gjuhësore në leksik etj. Janë shkrimet më të hershme të studiuesve më në zë të dy dhjetëvjeçarëve të parë të revistës ato që shtruan udhën dhe hapën horizont në këto fusha: nga Eqrem Çabej, Androkli Kostallari, Pashko Geci, Anton Krajni, Lirak Dodbiba, Sofika Morcka, Xhevat Lloshi, Emil Lafe, Ferdinad Leka, Filip Ndocaj, Palok Daka, Miço Samara etj. Disa çështje të leksikut janë trajtuar edhe në studime për kategori leksiko-gramatikore ose thjesht gramatikore, si: kuptimi leksiko-gramatikor (tek emrat e veprimet, te ndajfoljet, te parafjalët, te pasthirmat etj.); ose në studime për historinë e gjuhës, si: kuptimet e vjetruara e historike, zhvillimet semantike dhe ndërtimi e ndryshimi i strukturave kuptimore të fjalëve a të klasave leksikore në rrjedhën e kohës, tek autorët e vjetër etj.

Në të gjitha studimet dhe në karrierën tonë shkencore revista na ka tërhequr gjithnjë përpara për cilësi më të larta. Revista, duke rritur kërkesat, ka ardhur duke forcuar bazën teorike të studimeve që botonte, duke shfrytëzuar për herë të parë edhe metodat bashkëkohore të analizës gjuhësore, si, fjala vjen, analiza komponenciale a semike në semasiologji, sistemi konceptologjik

në terminologji etj. Ajo na ndihmoi edhe të specializoheshim në profilin shkencor sipas fushave të gjuhësisë. E përmend disa herë fjalën “cilësi”, sepse vërtet, cilësia e produktit shkencor që pasqyronte kjo revistë ka qenë vlera e saj më e madhe, madje edhe përtej arritjeve të studimeve shkencore, si strukturimi i revistës, gjuha e shkrimeve, rubrikat për kritikë e recensione shkencore ose për dokumente e materiale, bibliografia e studimeve e të tjera, që sillnin edhe informacion mjaft të dobishëm për ta përdorur në krijimtarinë shkencore.

Natyrisht, kërkesa më e parë në diskutimin e punimeve në redaksi ishte për përmbajtjen e studimit, për objektin e zgjedhur, për përshkrimin, analizën dhe argumentimin shkencor, për vërtetësinë e fakteve dhe nxjertjen e përfundimeve të drejta, por, pas kësaj, kërkesë e këtyre diskutimeve për çdo shkrim e autor, po aq e fortë, ishte për shprehjen gjuhësore normative, që nga drejtshkrimi e pikësimi deri te ndërtimi i frazave, për një gjuhë të pasur e të përpiktë. Mjaft të kujdesshme ishin, për të gjitha shkrimet e revistës, vërejtjet për pastërtinë e leksikut, për mënjanimin e fjalëve të huaja të panevojshme, për terminologji të njësuar e për mbështetjen e termave shqip. *Fjalori i terminologjisë së gjuhësisë*, që doli më 1974, jepte terminologjinë e njësuar e, sipas mundësisë, të shqipëruar të kësaj fushe dhe shërbente për këtë qëllim<sup>121</sup>. Diskutimet në redaksi dhe shkrimet e revistës ishin kështu “shkollë” edhe për zotërimin sa më mirë të gjuhës letrare dhe për pastërtinë e pasurimin e ligjërimit tonë shkencor, si dhe për gjithë atë rreth njerëzish që e shfrytëzonin këtë revistë, dikur shumë më i gjerë se sot, sepse revista rregullisht shkonte në çdo bibliotekë, në shkolla e në vatra kulture. Rrjedhimisht veprimi ndikues i saj në fushat përkatëse ka qenë më i hapët e më i fuqishëm.

Urimi është që kjo revistë, e njohur edhe jashtë Shqipërisë dhe që me prestigjin e saj ka bërë histori ndër gjithë organet shkencore albanologjike, të ngrihet vazhdimisht në nivele edhe më të larta se deri tash.

## SUMMARY

### THE JOURNAL “STUDIME FILOLOGJIKE” (PHILOLOGICAL STUDIES) – LANGUAGE TRAINING SCHOOL

Some of our linguists have started their career as researchers by publishing their first writings in the journal “Philological Studies”. Since their first steps, every author has benefited from the discussions of their articles on the editorial board of the journal, from the thoughts, ideas, comments and

<sup>121</sup> L. Dodbiba, F. Leka, S. Morcka, *Fjalori i termave të gjuhësisë (shqip – rusisht – frëngjisht)*, Tiranë, 1974.

advices of our scientific “fathers”, who taught us step by step how to understand the science of scientific methodology, how to have a wider knowledge of the Albanological heritage and how to get a deeper grasp of the Albanian language itself. The editorial board, like the journal itself, was truly a school of higher scientific qualification, firstly, with the works presented for publication, which were discussed there; secondly, with the discussions of our professors, which were a rich source of data and much more qualitative. Their discussions on the editorial board of this journal, and furthermore in the scientific sectors and the scientific council were a valuable help, a real school for our scientific shaping. Our professors were led by the spirit and the purpose of growing the values of published scientific papers. Even the professors sent their work to the editorial board of this journal.

All these made the editorial board a scientific environment of open discussions. The discussions were always free and of a high level. “Studime Filologjike” journal was always a summary of studies usually of high quality. Each issue of the journal had the value of a monograph. The studies, scientific articles and papers on lexicology, lexicography, phraseology and lexical semantics covered almost all the field of scientific research. Interdisciplinary issues, such as lexicon-semantic developments in historical and ethno-cultural terms, as well as the relation of Albanian language with other languages, Albanian etymological studies, features of Albanian lexicon in different periods of the Albanian society development, the intercommunication of lexical semantics and grammar, the combination of lexicon-stylistics with the literary stylistics, the lexicon legacy and neology, linguistic norm and culture in lexicon and so on.

In all the studies and in our scientific career the journal has always pushed us forward to higher quality. The quality of the scientific product has been the greatest value of this journal. Of course, the first requirements for the articles were for the content, the scientific analysis and argumentation, for the truth of the final facts. The requirements were equally strong for a normative language, for a rich and flawless language, a pure vocabulary, unified terminology etc. In this way, the discussions in the editorial board of the journal were also a “school” for a better command over literary Albanian and for the perfection of scientific discourse, for the cultivation of the standard language. Therefore, its influence in the relevant areas has been strong. This journal which was well known even abroad has made history with its prestige out of all scientific Albanological organs.

At the end of the this paper the author makes several proposals to expand the collaboration of the journal, for a better structure and a better functioning of the editorial board, to find a way to spread the scientific achievements of the magazine etc.

